

*REHABILITIM
RRUGA
PLLAKE
KULLURICE*

2017





Nr. 2126 Prot.

Tirane, me 21 / 07 / 2017

KONTRATË SIPERMARRJE

E lidhur sot me datë 21 / 07 / 2017 në **Bashkinë Finiq** midis palëve:

- **Bashkia Finiq** me adrese: Finiq Delvine - Tirane, përfaqësuar nga Kryetari **Z. Leonidha HRISTO** që ketu e në vijim do të quhet **“Autoriteti Kontraktor”**
- dhe,
- **2.T sh.p.k** përfaqësuar nga përfaqësuesi **ARTAN SAKO** me adrese **Rruga Asim Vokshi Njesia Bashkiake Nr 9 Ndertesa 14 AP 4 Tirane NIPT K01731001M**

Neni 1

Baza ligjore e kontrates:

- Ligji nr. 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- V.K.M. nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e Rregullave per Prokurimin Publik”,
- Kodi Civil: nenet 850 e vijues .
- Ligji nr. 8402, date 10.09.1998, “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar.
- V.K.M. nr. 68, date 15.02.2001, “Per miratimin e kushteve teknike te projektimit dhe zbatimit te punimeve te ndertimit”.
- Udhëzimi i K.M. nr. 3, date 15.02.2001 “Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit”.
- Udhëzimi i K.M. nr. 2, date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”.

Neni 2

Objekti i kontrates.

Objekti i kësaj kontrate është sipërmarja me objekt **“Rehabilitim Rruga Pllake-Kullurice”** ne perputhje te plote me planimetrine, skicat, grafikun e punimeve, specifikimet teknike, projektet, preventivin e punimeve si dhe te gjitha kushtet e parashikuara ne dokumentat e tenderit.

Autoriteti Kontraktor ngarkon kontraktuesin per ekzekutimin e punimeve dhe te gjitha veprimtarite perkatese qe jane objekt i kesaj kontrate dhe kontraktuesi e pranon nje gje te tille.





Neni 3

Vlera e kontrates dhe menyra e pageses.

Vlera e kontrates është **128 609 384** leke (Njeqind e njezet e tete milion gjashtëqind e nente mije treqind e tetedhjetë e kater)lekë me *tvsh*.

Ne vleren e pergjithshme te kontrates përfshihen punimet plus pajisjet si dhe te gjitha detyrimet fiskale ndaj shtetit dhe TVSH, pasqyruar sipas preventivit në aneksin e kontrates.

Pagesa do te behet me Urdher-Xhirimi brenda 30(tridhjetë) diteve nga data e paraqitjes se situacioneve pjesore nga Kontraktuesi dhe te miratuara nga Mbikeqyresi i Punimeve dhe autoriteti kontraktor si dhe konform dokumentave te tjera te specifikuara ne kontrate :

1. Fature me TVSH 1 origjinale + kopje
2. Situacioni pjesor,
3. Relacionit te Mbikeqyresit te punimeve.
4. Libreza e masave

Kontraktuesi duhet te siguroje dokumentacion fotografik apo videoregjistrues per castet me te rendesishme te zbatimit te punimeve, veçanerisht per ato qe behen te padukshme, qe mund te jene objekt diskutimi ne te ardhmen dhe qe pasqyrojne masat mbrojtese e te kontrollit te cilesise se materialeve te punimeve, etj, kopje te mjaftueshme i dorezohen mbykqyresit çdo jave.

Pagesa do te kryhet ne llogarine e kontraktuesit nga llogaria rrjedhese e Autoritetit Kontraktor, ne Banken _____ me nr. Llogarie _____.

Nga vlera e pergjithshme e kontrates do te ngurtesohet shuma prej 5% (pese) e cila do te sherbeje per te mbuluar defekte te ndryshme te verifikuara ne objekt, pergjate periudhes se garancise. Kjo shume do te ç'ngurtesohet brenda 30 (tridhjetë) diteve nga data e perfundimit te afatit te garancise.

Vlera e kesaj kontrate do te mbetet e pandryshueshme per gjithe periudhen e kohezgjatjes se saj.

Neni 4

Lloji i kontrates.


Kjo kontratë do të çmohet si një kontratë me Çmim Njesie të bazuar në çmimet e njesise të shprehura në Preventivin ne Njesi.

Neni 5

Sigurimi i Kontrates.

Sigurimi i kontrates eshte në shumën prej **12 860 938** leke duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: Jo me vone se 30 dite pas dates se marjes ne dorezim te punimeve, megjithate 5 % e vleres se





kontrates do te mbahet deri ne permbushjen e kenaqshme te detyrimeve te garancise, ku periudha e garancise se punimeve do te jete 12 muaj nga marrja ne dorezim e punimeve.

Neni 6 Mbikqyresi i Punimeve

Mbikqyresi i punimeve do te ndjeke punimet te cilat do te realizohen konform legjislacionit ne fuqi nen mbykeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit nga ana e Supervizorit te punimeve.

Mbikqyresi i punimeve eshte Drejtuesi i Projektit i emeruar nga Autoriteti Kontraktor. Detyrat e mbikqyresit te punimeve burojne nga aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi dhe detajohen ne kontraten qe lidhet me keta te fundit.

Ne rast se mbikqyresi do te ndryshohet Autoriteti Kontraktor njofton menjehere Kontraktorin. Drejtuesi i projektit do te vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Neni 7 Kantieri i ndertimit

Kantieri i realizimit te punimeve eshte ne fshatrat Pllake dhe Kullurice .

Kantieri i ndertimit do ti vihet ne dispozicion Kontraktuesit nga ana e Autoritetit Kontraktor menjehere pas lidhjes se kontrates.

Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit (mbikqyresi i punimeve) për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Kontraktori merr persiper te respektoje te gjitha rregullat e parashikuara nga legjislacioni mbi funksionimin e kantierit te ndertimit.

Neni 8 Te drejtat dhe detyrimet e Kontraktorit

Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet sipas afateve te percaktuara ne kete kontrate ne perputhje me grafikun e kryerjes se punimeve, me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit dhe konform legjislacionit ne fuqi.

Kontraktori merr persiper te kryeje punimet ne perputhje me zerat e punimeve te pranuar ne oferten e tij dhe gjithe dokumentacionin e tenderit.

Kontraktori merr persiper te ruaje deri ne perfundimin e kontrates çmimet e prezantuara ne oferten e tij.

Kontraktori merr persiper te jape çdo informacion qe i kerkohe nga Autoriteti Kontraktor/gjate realizimit te punimeve .





Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor.

Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kontraktori merr persiper te hartoje vete ose se bashku me Supervizorin e Punimeve dokumentacionin e duhur qe pas lidhjes se kontrates deri pas perfundimit te Akt-Kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te punimeve nga Autoriteti Kontraktor.

Kontraktori merr persiper te dorezoje çdo dokumentacion ne dy kopje origjinale per Autoritetit Kontraktor ne formen dhe afatet e kerkuara.

Kontraktori ka te drejte te kerkoje pagesen per realizimin e punimeve sipas afatit te percaktuar ne kete kontrate.

Neni 9

Te drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor merr persiper te vere ne dispozicion kantierin e ndertimit ne menyren qe Kontraktori mund te filloje kryerjen e punimeve.

Autoriteti Kontraktor merr persiper te dorezoje çdo dokumentacion te nevojshem qe kerkohet per kryerjen e punimeve (projekte, skica, etj).


Autoriteti Kontraktor merr persiper te caktoj nje Supervizor punimesh per te bashkerenduar me Kontraktiorin sipas legjislacionit ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor merr persiper te kryeje pagesat ne numrin e llogarise se Kontraktorit.

Neni 10

Garancia e Punimeve

Kontraktori merr persiper te garantoje punimet e tij per nje periudhe 1 (nje) vjecare nga data e aktit te kolaudimit te punimeve. Nese gjate kesaj periudhe verehen defekte te punimeve apo te ndertimit, te cilat jane rrjedhoje e mosbatimit me cilesi te projekt-preventivit nga ana e Kontraktorit ai do te nderhyje dhe do te beje eliminimin e tyre me shpenzimet e tij.





Ne perfundim te periudhes se garancise Autoriteti Kontraktor, kolaudatori, Supervizori i punimeve dhe Kontraktori bejne kontrollin perfundimtar te vepres. Per defektet qe nuk jane ndrequr, gjate periudhes se garancise se punimeve, Autoriteti Kontraktor llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlera e garancise se punimeve.

Nese pas dates se neneshkrimit te kontrates , ndonje ligj, rregullore, urdherese, urdher ose procedure me efektin e ligjit ne Republiken e Shqiperise hyn ne fuqi, nxiret ose ndryshon dhe ndikon kushtet ose çmimin e kontrates do te rregullohet ne ate mase sa Kontraktori eshte ndikuar ne permbushjen e detyrimeve te tij sipas kontrates.

Neni 11 Forca Madhore

Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 12 Marrja perfundimtare ne dorezim


Autoriteti Kontraktor do te marre perfundimisht ne dorrezim objektin pas hartimit te aktit te kolaudimit dhe miratimit sipas afateve te percaktuara ne aktin e kolaudimit, bazuar ne dokumentacionin e marrjes ne dorezim te objektit.

Neni 13 Origjina e Materialeve.

Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Materialet qe do te perdoren nga Kontraktuesi ne objekt do te jene ne perputhje me specifikimet teknike dhe do te shoqerohen me origjinen e tyre e dokumenta te tjera te cilat do te aprovohen para se te vihen ne objekt nepermjet Drejtuesi te Projektit.

Neni 14





Komunikimi.

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet **me shkrim.**

Neni 15 Ekzekutimi i Punimeve.

Afati për realizimin e punimeve objekt i kësaj kontrate fillon me nënshkrimin e procesverbalit të fillimit të punimeve midis sipërmaresit dhe mbikeqyresit të punimeve dhe perfundon brenda **120 (njëqind e njezet) diteve kalendarike.**

Neni 16 Sigurimi Teknik dhe Mjedisor.

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17 Raportimi i Grafikut të Zbatimit.

Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.



Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur. Kontraktuesi do të plotësojë programin sipas grafikut të parashikuar.

Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 18 Sigurimi.

Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në Afatin e Realizimit të Plote:

Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve,
Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve,
Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve,
Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier.





Neni 19 Testimet dhe Inspektimet.

Kontraktori është i detyruar që me shpenzimet e veta të kryejë provat laboratorike të materialeve që do të përdoren në objekt si dhe provat e kampioneve të marra nga objekti në përputhje me udhëzimet e dhena nga Mbikqyresit dhe Punimeve dhe normativat në fuqi.

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të parashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës.

Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Inspektimet dhe testimet para vertetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: cilësinë e punimeve, qëndrueshmërinë, jetegjatesinë dhe përputhshmërinë me projektin dhe me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.


Neni 20 Garancitë.

Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 21 Vonesa në Bërjen e Pagesës.

Shperblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.





Municipality of Phoenice

Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) te provoje ndonje dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 22 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit.

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shumën e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 23 Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve.


Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme: Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates

Neni 24 Mbarimi i Punimeve, Kolaudimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve.

Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerrat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.





Municipality of Phoenice

Pas perfundimit te Puneve dhe korrjimit te defekteve Drejtuesi i Projektit leshon certifikaten per mbarimin e Punimeve dhe njofton Autoritetin Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor me marrjen e ketij njoftimi nga Drejtuesi i Projektit, brenda 30 diteve duhet te beje kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te objektit. Ne qofte se gjate periudhes se kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te objektit, konstatohen te meta apo mangesi te cdo natyre mbahet procesverbal i vecante duke caktuar nje afat per riparimin e te metave dhe plotesimin e mangesive nga Kontraktuesi me shpenzimet e ketij te fundit. Pas riparimit te defekteve nese ka dhe korrjime te nevojshme per llogarine perfundimtare te shumes totale dhe pas marrjes se procesverbalit te kolaudimit, Autoriteti Kontraktor do te leshoje certifikaten e marrjes ne dorezim te punimeve.

Ne perfundim te periudhes se garancise per defektet Autoriteti Kontraktor, Kolaudatori, Drejtuesi i Projektit, Inxhinieri Zbatues i Punimeve bejne kontrollin perfundimtar te vepres. Per defektet qe nuk jane ndrequr gjate periudhes se garancise se punimeve, Autoriteti Kontraktor llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesa nga vlera e garancise prej 5 % per defektet.

Neni 25

Ndërprerja për Mosplotësim.

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj

Neni 26

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit.


Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 27

Zgjidhja e Mosmarrveshjeve.

Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, atehere ato do t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative





**Neni 28
Lajmërimet.**

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 29
Llogaritja e Afateve.**

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

**Neni 30
Zgjidhja e Kontrates**

Autoriteti Kontraktor mund të zgjidhë kontratën dhe në të njëjtën kohë të beje konfiskimin e garancisë së sigurimit të kontratës nëse kontraktori bën shkelje themelore të kontratës. Shkelje themelore të kontratës përveç rasteve të tjera të parashikuara në këtë kontratë përfshihen por nuk kufizohen për sa vijon:

Kontraktori ndalon punimet pa autorizimin e drejtuesit të punimeve

Kontraktori vonon kryerjen e punimeve pa shkaqe të parashikuara në këtë kontratë ose nuk korrigjon defektet sipas afateve të vendosura.

Në rastin e prishjes së kontratës për shkaqet e mësipërme të gjitha mallrat dhe materialet e levruara dhe të përdorura për realizimin e punimeve nga ana e Kontraktorit si dhe vlera e punimeve të kryera për llogari të Autoritetit Kontraktor do të konsiderohen prona e Autoritetit Kontraktor

**Neni 31
Dispozitat e fundit.**

Për çdo gjë që nuk është parashikuar në këtë kontratë, në rast interpretimesh të ndryshme, për bazë do të merren Kushtet e Përgjithshme të Kontratës në dokumentat standarte të tenderit, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore dhe nënligjore të përmendura në Nenin 1 të kësaj kontrate.

Kjo kontratë fillon të zbatohet menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe firmoset në pesë kopje origjinale, nga të cilat katër për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin. Palet pasi e lexuan dhe e gjeten atë konform ligjit dhe interesave të tyre e nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të plote.





Municipality of Phoenice

Neni 32
Ndjekja e zbatimit te kontrates

Ngarkohet **Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit te Territorit prane Bashkise Finiq** per ndjekjen e kontrates te cilet raportojne tek Titullari i Autoritetit Kontraktor per realizimin e kontrates deri ne perfundimin e saj.

KONTRAKTUESI
"2T" SH.P.K
P/LIGJOR
ARTAN SAKO

Artan Sako



AUTORITETI KONTRAKTOR
"BASHKIA FINIQ"
KRYETARI
LEONIDHA TRISTO

